

VENDIM
Nr. 46, datë 22.1.2020

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E ENTIT
KOMBËTAR TË BANESAVE SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar “Zonë të re për zhvillim”, të zonës 1/1, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Enti Kombëtar i Banesave caktohet si njësi zbatuese për këtë zonë:

a) për të bërë kërkesën për nisjen e procesit për shpronësimin dhe/ose shkëmbimin në zonën e re për zhvillim, sipas parashikimeve të legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi;

b) për çdo veprim tjetër, në funksion të rindërtimit të kësaj zone, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave, Bashkia Kurbin dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

